



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM

Nr. 3, Dt. 21.01.2011

Per shfuqizim te vendimit nr. 3 date 21.05.2010 te K.B.U "Vjose" dhe anullim te lejes per shfrytezim te materialeve inerte ne shtratin e lumit Shushice, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Lubonje (ne perendim dhe ne veriperendim te tij), subjektit "Halili" sh.p.k, komuna Shushice, Qarku Vlore.

Ne mbeshtetje te Vendimit te K.K.U-se, Nr.1, Dt. 13.01.2010 "Per ndalimin e perkohshem te dhenies te lejeve te reja per shfrytezimin e zhavorreve ne shtreterit e lumenjve", si dhe shkreses Nr. 4254 Prot, Dt. 30.07.2010 te derguar nga M.M.P.A.U, prej Ministrit Z. Fatmir Mediu, "Mbi rinovimin e lejeve te shfrytezimit te zhavorreve", si dhe ne germen "d" te "nenit 18" te Ligjit Nr.8093, Dt. 21.03.1996 "Per rezervat ujore", thuhet se: "Lejet, Autorizimet dhe Konkensionet nuk mund te refuzohen pa nje vendim te motivuar", prandaj mbeshtetur ne legjislacionin e siperpermendur, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1 Shfuqizimin e vendimit Nr. 3, Date 21.05.2010, te K.B.U "Vjose" dhe anullim te lejes per shfrytezim te materialeve inerte ne shtratin shtratin e lumit Shushice, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Lubonje (ne perendim dhe ne veriperendim te tij), subjektit "Halili" sh.p.k, komuna Shushice, Qarku Vlore.

2. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.

3. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"

Ardian DINE



KRYETARI I K.B.U "VJOSE"

Eduart VECANI

